



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr.453 Prot

Përmet, më 19.02.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “NIKA” shpk

Procedura e prokurimit: *Kërkesë për propozim*

Numri i referencës së procedurës: *REF- 84593-01-22-2021*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *“Loti i II Blerje ushqime me origjinë shtazore”*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): s’ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët X* oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “NELSA” sh.p.k me NIPT J71601012S me vlerë të ofertës 1 063 620 (një milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “NIKA” sh.p.k me NIPT J76705047U me vlerë të ofertës 1 002 110 (një milion e dy mijë e njëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “SILVER” sh.p.k me NIPT K88010301S me vlerë të ofertës 1 077 610 (një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

- **Operatori “NELSA” shpk**

1. Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika dh) Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Ky OE ka paraqitur vërtetim të datës 29.12.2020 i cili përfshin faturën koherente të muajit Nëntor 2020 me vlerë të llogaritur deri në 28.12.2020. Tenderi hapej në 04.02.2021 dhe duhej përsirë fatura e muajit janar 2021.

2. Në lidhje me pikën 2.3.3 punësimin e 1(një) shoferi për të cilin duhet të paraqesë kontratë pune ka paraqitur një kontratë pune të lidhur midis punëdhënësit shoqëria "Nelsa" shpk dhe punëmarrësit Z. Nexhmi Balla e datës 13.05.2018 ku në nenin 2 të saj është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës për një afat prove 3(tre) muaj në fund të të cilit nëse palët bien dakord të zgjasin afatin e kontratës së punës, duhet të bëjnë një aneks të kësaj kontrate, ku mund të parashikohen edhe kushte të tjera. Po kështu në nenin 10 të kësaj kontrate thuhet që Kontrata e punës përfundon në afatin e parashikuar në Nenin 2. Pra mungon një ankes kontrate për zgjatje afati të kontratës së punës. Po kështu në librezën e punës nuk është përcaktuar detyra si Shofer por vetëm detyra si Menaxher/ Administrator që prej 19.02.1997.
3. Në pikën 2.3.7 për automjetin e disponuar me targë AA624ZH (ATP) me nr shasie WF0XXXTTGXKL52233 mungon kontrata e qerasë financiare noteriale e lidhur midis Albanian Financial Institucion shpk dhe NELSA shpk që provon dhënien e këtij automjeti me qera.

Oferta te kualifikuara:

- Operatori ekonomik "NIKA" shpk

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se *operatori ekonomik "NIKA" shpk*, plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DT të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik "NIKA" shpk me adresë Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godinë 8-katëshe, kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587 SHKODËR* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme *1 002 110 (një milion e dy mijë e njëqind e dhjetë) lekë pa TVSH* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi "Abdyl Frashëri" kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.02.2021

Ankesa: NUK KA

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Alma HOXHA